



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH II.nr.531/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtarin Faton Bajrami në çështjen përmbarimore të kreditorit Banka për Biznes (BpB), me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson “Debt Loan Recovery” Sh.P.K., me seli në Prishtinë, rr. “Enver Maloku” nr.108, kati i dytë, kundër debitorëve, N.T.P. “Getoar – AG” me numër të regjistrimit të biznesit 80284098 të cilën e përfaqëson A.M. nga Gjakova, rr. “Naim Frashëri” dhe N.M. i përfaqësuar me përfaqësuesin e përkohshëm A.M., me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i Përgjithshëm, KPPP.nr.723/22 të datës 14.12.2023, me datë 05.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e debitorëve N.T.P. “Getoar – AG” me numër të regjistrimit të biznesit 80284098 të cilën e përfaqëson A.M. nga Gjakova, rr. “Naim Frashëri” dhe N.M. i përfaqësuar me përfaqësuesin e përkohshëm A.M., ndërsa aktvendimi Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i përgjithshëm, KPPP.nr.723/22 të datës 14.12.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.723/22 të datës 14.12.2023, në dispozitivin e aktvendimit e ka hedh poshtë si të palejuar prapësimin e debitorëve N.T.P. “Getoar – AG” me numër të regjistrimit të biznesit 80284098 të cilën e përfaqëson A.M. nga Gjakova, rr. “Naim Frashëri” dhe N.M. i përfaqësuar me përfaqësuesin e përkohshëm A.M., paraqitur kundër Konkluzionit P.nr.05/17 të datës 09.06.2021 të lëshuar nga Përmbaruesi Privat Gëzim Gjoshi, me seli në Gjakovë.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor kanë ushtruar ankesë debitorët (*me pretendime sikur në ankesë*), me propozim që Gjykata e Shkallës së Dytë, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i Përgjithshëm, KPPP.nr.723/22 të datës 14.12.2023.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

- **Ankesa e debitorëve është e pathemeltë.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh Përmbartuesi Privat, duke vepruar në bazë të Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë PPP.32/17 lidhur me borxhin në lartësi prej 29.168.99 €, më 09.06.2021 kishte zhvilluar ankandin publik për shitjen paluajtshmerisë së hipotekëlënësit N.M.. Përmbartuesi Privat kishte nxjerr Konkluzionin P.nr.05/17 me të cilin konstatohet shitja e paluajtshmerisë së debitorit, N.M.. P-...3 dhe atë: 1. Shfrytëzimi aktual i parcelës, oborr në sipërfaqe 500 m2 ; 2. Shfrytëzimi aktual i parcelës shtëpi – ndërtesë në sipërfaqe prej 154 m2 ; 3. Shfrytëzimi aktual i parcelës pemishte e klasit të tretë në sipërfaqe prej 62 m2 , Zona Kadastrale Gjakovë – Qytet në sipërfaqe të përgjithshme prej 716 m2 e evidentuar sipas certifikatës së pronës dt. 09.06.2021-9-28. Tutje në konkluzion theksohet se paluajtshmeria e lartcekur i shitet, blerësit Q.B., pjesëmarrës në ankandin e mbajtur më datën 09.06.2021 në shumën prej 46,500.00€ (dyzet e gjashtë mijë e pesëqind euro).

Debitori përmes përfaqësuesit të autorizuar dhe A.M. i cili njëherit është edhe përfaqësues i përkohshëm i të ndjerit N.M. më 21.06.2021 kishte ushtruar prapësim ndaj Konkluzionit P.nr.05/17 të datës 09.06.2021, me pretendimin se konkluzioni i atakuar është i kundërligjshëm. Debitori ka kundërshtuar rregullsinë, afatshmerinë dhe legjitimitetin e konkluzionit P.nr.05/17 të datës 09.06.2021. Sipas debitorit aktualisht është duke u zhvilluar procedurë kontestimore në Gjykatën Themelore në Prishtinë lidhur me përcaktimin e lartësisë së borxhit, andaj ka kërkuar nga gjykata që të aprovoj prapësimin e debitorit në tërësi si të bazuar.

Kreditori, përmes përfaqësuesit të autorizuar ka paraqitur përgjigje në prapësim, përmes së cilës ka kërkuar që prapësimi i debitorit të hedhet poshtë. Sipas kreditorit, ndaj konkluzionit të Përmbartuesit Privat nuk mund të ushtrohet mjet juridik, po ashtu ka shtuar se nuk qëndrojnë as pretendimet e debitorit përkitazi me lartësinë e borxhit siç theksohet në prapësim. Gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta hedh poshtë dhe në përputhje me Konkluzionin P.nr.05/17 të vazhdohet me procedurën përmbartimore.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i Përgjithshëm duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit dhe përgjigjen në prapësim të kreditorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar KPPP.nr.723/22 të datës 14.12.2023, ku në dispozitivin e aktvendimit e ka hedh poshtë si të palejuar prapësimin e debitorëve N.T.P. “Getoar – AG” me numër të regjistrimit të biznesit 80284098 të cilën e përfaqëson A.M. nga Gjakova, rr. “Naim Frashëri” dhe N.M. i përfaqësuar me përfaqësuesin e përkohshëm A.M., paraqitur kundër Konkluzionit P.nr.05/17 të datës 09.06.2021 të lëshuar nga Përmbartuesi Privat Gëzim Gjoshi, me seli në Gjakovë.

Në arsyetim të aktvendimit gjykata ka vlerësuar se ndaj Konkluzionit P.nr.05/17 të datës 09.06.2021 të lëshuar nga Përmbaruesi Privat Gëzim Gjoshi, nuk është lejuar mjete juridik, respektivisht prapësimi i debitorit nuk është i lejuar.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarimore kur e ka refuzuar prapësimin e debitorit, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate ndaj Konkluzionit, nuk është lejuar mjete juridik, respektivisht prapësimi i debitorit nuk është i lejuar.

Andaj, duke iu referuar nenit 3, par 5 të Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, ku përcaktohet se: “5. Konkluzioni nxirret për zbatimin e disa veprimeve dhe për drejtimin e procedurës.”. Ndërkaq me nenin 3 të Ligjit Nr. 05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, përcaktohet se: “3 Neni 3 i ligjit bazik, pas paragrafit 5., shtohet paragrafi i ri 6., me tekstin si vijon: 6. Kundër konkluzionit nga paragrafi 5. i nenit 3 të ligjit nuk është i lejuar mjete juridik, Gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka dhënë aktvendim në pajtim me dispozitat ligjore. Prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata e shkallës së dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykatë i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar.

Gjykata vlerësoi pretendimet e debitorit por te njëjtat mbesin te pabazuara pasi nuk ka arrit ti argumentoj me prova juridikisht te vlefshme ashtu siç kërkon neni 69.4 i LPP dhe si te tilla i refuzoj ndërsa aktvendimin e ankimuar e vërtetoj. Përndryshe në procedurën përmbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbarimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhoma e shkallës së dytë
K.DH.SH.II nr.531/24 me datë 05.06.2024

Gjyqtari
Faton Bajrami